



## **Këtë javë në komisionet parlamentare**

### **■ U shqyrtuan 7 projektligje të rëndësishme:**

- “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”;
- “Për prokurimin publik”;
- “Për disa ndryshime në ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent për huamarrësin, dhe Bashkimit Evropian, si huadhënës, për ndihmën makrofinanciare për Shqipërinë” ;
- “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Programin për Zhvillimin e Turizmit dhe Infrastrukturës në Shqipëri”;
- 
- “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin për reagimin ndaj emergjencës COVID-19 në Shqipëri”;
- “Për një ndryshim në ligjin nr.55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar".

# Seanca plenare

## ■ Kuvendi miratoi tre projektligje, një Akt Normativ dhe 2 projektvendime

Kuvendi u mbledh në seancë plenare dhe miratoi:

### Projektligjet

-“Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për projektin bashki të forta”;

-“Për censin e popullsisë dhe të banesave”;

- “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 163/2014 “Për Urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

### Projektvendimet

-“Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve me kohë jo të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”;

-“Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”.

### Akti Normativ

-Akt normativ nr. 32, datë 12.10.2020 “Për një ndryshim në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar”

## ■ Kuvendi mban një minutë heshtje për viktimat e tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019. Kryetari i Kuvendit përkujtoi viktimat dhe nxiti qeverinë për realizimin e objektivave të rindërtimit

Kryetari i Kuvendit, në fjalën hapëse të seancës së sotme plenare, përkujtoi 1-vjetorin e tërmetit të fuqishëm të 26 nëntorit të vitit 2019, që shkaktoi 51 vdekje dhe mbi tre mijë të plagosur. Z. Ruçi e vuri theksin të solidariteti i treguar nga qytetarët dhe nga përpjekjet e pandalura të qeverisë për të rikthyer përmes rindërtimit qytetarët në strehët e tyre. Kryetari Ruçi u shpreh se përpjekjet për rikthimin e qytetarëve në shtëpitë e tyre të rindërtuara apo të reja nuk u ndalën nga pandemia e Covid-19. Z. Ruçi u shpreh se Kuvendi e inkurajon punën e qeverisë për realizimin e objektivave të rindërtimit edhe në kushtet e kostove që imponoi pandemia. Z. Ruçi kërkoi mbajtjen e 1 minute heshtje në përkujtim të viktimave të vitit të shkuar.

## Aktivite parlamentare

### ■ Mblidhet Konferenca e Kryetarëve

**25 Nëntor 2020** - Konferenca e Kryetarëve miratoi programin e punës për periudhën 30 nëntor-25 dhjetor 2020 dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 30 nëntor - 18 dhjetor 2020. Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, njoftoi Konferencën se në përgjigje të kërkesës së tij të datës 18 nëntor 2020, Komiteti Teknik i Ekspertëve dhe Ministria e Shëndetësisë, konfirmojnë se “Urdhëri nr. 633, datë 11.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, nuk çënon aktivitetin e Kuvendit për zhvillimin e seancave plenare. Seancat plenare duhet të zhvillohen duke ruajtur rregullat e distancimit social dhe mundësisht të kenë kufizime në kohëzgjatje.” Në këto rrethana, kohëzgjatja e seancave do të shkurtohet në tre orë. Konferenca vendosi zhvillimin e seancave plenare me datat 3 dhe 17 dhjetor 2020. Konferenca vendosi t’i përcjellë seancës plenare kërkesën e një grupi deputetësh për ngritjen e një Komisioni të Posaçëm të Kuvendit për administrimin e dokumentacionit dhe hartimin e një raporti mbi gjetjet dhe konkluzionet e verifikimeve të kryera nga institucionet përkatëse në Shqipëri mbi çështjet e raportit të anëtarit të APKiE Dick Marty mbi rolin e përfaqësuesve politikë dhe institucioneve publike shqiptare në ndihmë të të ashtuquajturës veprimtari kriminale e drejtuesve të UÇK-së në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### ■ Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashme, takohet me z. Mohamed Heider, Ambasador i Egjyptit në Republikën e Shqipërisë

**25 Nëntor 2020** - Kryetarja e Komisionit për Politikën e Jashme, znj. Mimi Kodheli pati një takim kortezie me Ambasadorin e ri të Egjyptit në Republikën e Shqipërisë, SH.T.Z. Mohamed Heider. Ambasadori Heider, pasi falenderoi për mikpritjen, uroi zonjën Kodheli për zgjedhjen e saj në postin e lartë të Zevendëspresidentes së Asamblesë Parlamentare të NATO-s, duke e konsideruar këtë zgjedhje si mjaft të rëndësishme jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin. “Shqipëria,- tha ai,- është një gur themeltar për sigurinë dhe bashkëpunimin në Ballkan, roli i së cilës po rritet vazhdimisht në organizatat ndërkombëtare si në NATO, OSBE dhe, me shumë gjasa, së shpejti edhe në Këshillin e Sigurimit të OKB-së”. Më tej ambasadori theksoi interesin e veçantë të Egjyptit ndaj Shqipërisë, si një vend me të cilin e bashkojnë lidhjet historike dhe ndjenjat miqësore. Në këtë kuadër ai shprehu vullnetin e Egjyptit për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis dy vendeve. Duke folur për marrëdhëniet ndër-parlamentare, ai nënvizoi rolin e grupeve parlamentare të miqësisë dhe nevojën për t’i ripërtëritur e intensifikuar kontaktet midis tyre. Znj. Kodheli pasi e falenderoi Ambasadorin egjyptian për urimet, vlerësoi rëndësinë e marrëdhënieve historike midis dy vendeve dhe ndienjat miqësore që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë midis popujve tanë. Ajo theksoi se këto lidhje duhet të ravijëzojnë edhe qëndrimin e Egjyptit ndaj shqiptarëve si një komb dhe Kosovës si shtet i pavarur. Më tej bashkëbiseduesit folën mbi aspekte të veçanta të bashkëpunimit në fushën politike, ekonomike e të turizmit.

### ■ Aleanca e Grave Deputete trajnim dy ditor online me fokus komunikimin publik dhe fuqizimin e rolit të grave në zgjedhjet parlamentare

**25 Nëntor 2020** - Aleanca e Grave Deputete, më 24.11.2020 dhe 25.11.2020, mori pjesë në një trajnim dy ditor online me fokus komunikimin publik dhe fuqizimin e rolit të grave në zgjedhjet parlamentare. Ky trajnim u zhvillua nën drejtimin e ekspertit z. Johan Hamels. Dita e parë e trajnimit u fokusua në trajtimin e temës“ Listat e hapura dhe kandidimi i grave dhe vajzave”. Në këtë sesion ishin të ftuara tre gra deputete: znj. Gudrum Kugler , deputete në Austri, znj. Inka Hopsu, deputete në Finlandë dhe znj. Mimoza Kusari Lila, deputete në Kosovë. Deputetet e ftuara ndanë me Aleancën e Grave Deputete, eksperiencat e tyre, vështirësitë dhe sfidat e të qenurit grua deputete si dhe diskutuan lidhur me rëndësinë e profilizimit të grave në një fushë të caktuar si dhe mbështetja ndaj njëra - tjetrës. Më tej, eksperti Johan Hamels prezantoi mënyrën e mbledhjes së fondeve për fushatën zgjedhore. Në përfundim, gratë deputete pjesëmarrëse diskutuan dhe ndanë eksperiencat e tyre me të ftuarit. Dita e dytë e trajnimit online u ndal në temën “Listat e hapura dhe aksesit në financat politike për kandidatet gra dhe vajza”. Në këtë sesion ishin të ftuara dy gra deputete: znj. Mirjam Sterk deputete në Hollandë dhe znj. Miriam Lexmann, deputete nga Sllovakia. Ato ndanë eksperiencat e tyre për mënyrën e mbledhjes së fondeve si dhe eksperiencat e tyre personale si deputete gra. Më tej, gratë deputete u ndanë në grupe të vogla pune. Në vijim, eksperti Johan Hamels prezantoi disa hapa konkretë për mënyrën e mbledhjes së fondeve. Ky trajnim u zhvillua në kuadër të sesionit të katërt dhe të pestë të Akademisë së Liderimit duke përfunduar pjesën teorike të trajnimeve dhe për të vijuar më tej me sesione trajnimi individuale të grave deputete pjesë e Aleancës së Grave Deputete. Trajnimi u organizua nga Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje në bashkëpunim me Institutin Kombëtar për Demokraci (NDI) dhe mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri.

### ■ Kuvendi i Shqipërisë i bashkohet fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore

**26 Nëntor 2020** - Me nismën e Nënkomisionit të Barazisë Gjinore dhe Parandalimit të Dhunës ndaj Gruas dhe Aleancës së Grave Deputete, me mbështetjen e UN Women Shqipëri, Kuvendi i Shqipërisë iu bashkua sot fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore me sloganin "Dëgjo, Beso, Mbështet gratë dhe vajzat". Deputetët u ndalën në dy stendat e vendosura në hyrje në sallën e seancave plenare, ku ishin vendosur maska dhe spila me simbolin e fushatës, në shenjë sensibilizimi për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjes për parandalimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Aktivitete të tilla sensibilizuese po organizohen nga parlamentet në shumë vende të botës. Nga data 25 nëntor- 10 dhjetor të çdo viti zhvillohet fushata e 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore. Shkelja e të drejtave të grave është shkelja më e përhapur e të drejtave të grave në të gjithë botën. Nëpërmjet veprimeve të koordinuara synohet ndërgjegjësimi i publikut, institucioneve, rritja e përgjegjshmërisë dhe mbështetja për të mbijeturat/ mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

## Aktivite të Kryetarit të Kuvendit



**23 nëntor 2020**

- Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, priti Kryetarin e ri të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, z. Vincenzo Del Monaco: Prezenca e OSBE në Tiranë, partner i besueshëm për Shqipërinë

**24 nëntor 2020**

- Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, priti Ambasadorin e Rumanisë, z. Mircea Perpelea: Të rivitalizojmë shkëmbimet politike e bashkëpunimin ekonomik



**25 nëntor 2020**

- Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, priti priti Ambasadorin e Katarit, z. Ali bin Hamad Al-Marri: Katari avancon drejt valëve të demokratizimit

## Aktivite të Kryetarit të Kuvendit



**28 nëntor 2020**

-Kryetari i Kuvendit,  
z. Gramoz Ruçi, mori  
pjesë në ceremoninë  
e organizuar me rastin e 28  
Nëntorit, në Vlorë

**29 nëntor 2020**

- Kryetari i Kuvendit,  
z. Gramoz Ruçi, mori  
pjesë në ceremoninë e  
organizuar me rastin e  
29 Nëntorit, në Varrezat  
e Dëshmorëve të Kombit



## Mesazhe urimi të Kryetarit të Kuvendit

### ■ Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, letër krerëve të Drejtësisë dhe Policisë: Zbatoni me rigorozitet dispozitat e Kodit Penal mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave

**27 Nëntor 2020** - Në kuadrin e ditëve të fushatës kundër dhunës ndaj grave, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, u është drejtuar me një letër krerëve të Drejtësisë dhe Policisë për zbatimin e legjislacionit kundër dhunës ndaj grave e vajzave. Letra u është drejtuar znj. Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Gent Ibrahim, Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Olsian Çela, Prokuror i Përgjithshëm dhe z. Ardi Veliu, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. “Kuvendi i Shqipërisë, në dhjetor të vitit 2017, ka miratuar Rezolutën “Për dënimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjore për parandalimin e tij”. Dhuna ndaj grave dhe vajzave, si një nga format mbizotëruese të dhunës, është një dukuri globale që prek të gjitha vendet, shoqëritë, komunitetet fetare dhe etnike. Parandalimi dhe lufta kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave është parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm, të barasvlershëm dhe përfshirës, si dhe një vlerë dhe objektiv i rëndësishëm i qytetërimit të sotëm. Në vitet e fundit, në vendin tonë, ka pasur zhvillime pozitive lidhur me hartimin ose përmirësimin e legjislacionit kundër dhunës në familje, që kanë përmirësuar ndjeshëm mënyrën se si i trajtojnë institucionet rastet e dhunës kundër grave dhe vajzave dhe dhunën në familje. Por, pavarësisht zhvillimeve pozitive, të dhënat për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, tregojnë se dhuna është ende e pranishme dhe shfaqet në forma të ndryshme deri tek më ekstremet, ku më së shumti viktimat janë gratë dhe fëmijët. Sipas raportit të GREVIO, dobësitë më të mëdha që prekin mekanizmat e referimit kanë të bëjnë me mungesën e zbatimit të duhur të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes nga përmbarimi, përgjigjet e papërshtatshme nga sistemi i gjykatave dhe një përfshirje e pamjaftueshme e profesionistëve të shëndetit, përfshirë këtu mjekët ligjorë. Kuvendi i Shqipërisë vëren se sistemi i drejtësisë (policia, prokuroria, gjykatat, shërbimet sociale në sistemin e drejtësisë penale) nuk ka qenë efektiv sa duhet lidhur me hetimin dhe shqyrtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore të Kodit Penal për dënimin e dhunuesve dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat. Pavarësisht se qasja holistike kundër dhunës ndaj grave nuk mund të mbështetet vetëm në sistemin e drejtësisë penale, gjykatat duhet të jenë në një linjë me qëndrimin e vendosur të ligjvënësit kundër dhunës dhe të ofrojnë një reagim të fuqishëm, duke përfshirë edhe ndëshkimet. Kjo do të nxiste raportimin e mëtejshëm të rasteve të dhunës në familje. Ndonëse ka një përmirësim të qartë në respektimin e afateve të gjykimit të kërkesave për lëshimin e urdhëra të mbrojtjes, ende shtyhen në mënyrë të panevojshme seancat gjyqësore për vërtetimin dhe lëshimin e tyre. Shpejtësia dhe respektimi i afateve, përbën një element thelbësor të gjykimit për urdhrat e mbrojtjes, mosrespektimi i të cilave sjell humbjen e kuptimit të ligjit kundër dhunës në familje dhe mund të vërë në rrezik viktimat. Në këto kushte, kërkoj nga ana juaj të merrni masat e nevojshme për zbatimin rigoroz të dispozitave të Kodit Penal mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave.”, shkruan në letrën e tij Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.

## Mesazhe urimi të Kryetarit të Kuvendit

### ■ Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, mesazh me rastin e 65-vjetorit të lindjes së Heroit të Kosovës, Adem Jashari: Ditëlindja e Bacës dhe ditëlindja e Shqipërisë së Pavarur, një përkim dhe simbolikë e fuqishme

**28 nëntor 2020** - Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, ka sot një mesazh me rastin e 65-vjetorit të lindjes së Heroit të Kosovës, Adem Jashari. “Adem Jashari, Heroi i Kosovës, komandanti legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sot do të ishte 65 vjeç. Por prej 22 vjetësh, nga 7 marsi i vitit 1998, ai, familja, miqtë e të afërmit, Kosova, Shqipëria, të gjithë ne, e kremtojmë ditëlindjen e Adem Jasharit pa Adem Jasharin. Dhe pa pothuajse të gjithë pjestarët e familjes Jashari, pesëdhjetë e pesë prej të cilëve u vranë bashkë me të, pas një beteje treditore me mijra forca, tanke e automjete të armatosura të policisë serbe, në ngjarjen që ka hyrë në histori si masakra e Prekazit. Jo vetëm ne, bashkëkombasit e Ademit, por të gjithë njerëzit e drejtë e të ndershëm anembanë globit, në ndeshjen midis tankeve e dhunës policore dhe njerëzve që luftojnë për liri, janë me njerëzit, me luftëtarët. Nga trashëgimtarët e Adem Jasharit ka mbetur vetëm Besarta, e cila është e mbijetuara e vetme e familjes së tij, dhe që në atë ditë të masakrës ishte vetëm 11 vjeç. Më dhemb dhimbja e Besartës, që nuk uron dot Bacën në këtë përvjetor. Më ther plaga e saj, e pashëruar dhe e pashërueshme, që në këtë përvjetor, në ata që kaluan dhe në ata që do të vijnë, do të jetë pa motrat, vëllezërit, prindët, pa familjarët e saj të dashur. Por Besartës i them se nuk është vetëm. Me të është Kosova e Shqipëria dhe të gjithë njerëzit që aspirojnë për lirinë, drejtësinë dhe të vërtetën. Masakra e Prekazit ishte jo vetëm rënia e Adem Jasharit dhe familjes së tij, por një thirrje për burrat dhe gratë e Kosovës, për t’u bashkuar dhe për t’i shkuar deri në fund misionit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës dhe ndërtimin e një shoqërie të drejtë, ku të gjithë qytetarët e saj të jetojnë të lirë e të barabartë. Kjo ngjarje filloi t’i dëshmojë komunitetit ndërkombëtar të vërtetën e luftës çlirimtare të popullit kosovar, të udhëhequr nga Ushtria e tij Çlirimtare. Ditëlindja e Adem Jasharit përkon me ditëlindjen e Shqipërisë së Pavarur. Natyrisht, kjo është një rastësi kohore. Por ky përkim, që bashkon Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë me ditëlindjen e heroit që ra për Kosovën e lirë e të pavarur, bëhet një simbolikë e fuqishme. "Bac u kry", ishte shprehja që, në ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, më 7 shkurt 2008, sintetizoi mirënjohjen e përjetshme të të gjithë shqiptarëve për veprën e nisur nga Adem Jashari dhe të përmbushur nga Ushtria Çlirimtare, populli dhe institucionet e Kosovës. Ditëlindja e Adem Jasharit është një moment reflektimi, për të vlerësuar e respektuar veprën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe komandantit të saj legjendar, çlirimin e Kosovës dhe pavarësinë e saj, të arritur me mbështetjen e në partneritet me aleatët e mëdhenj dhe strategjikë të Shqipërisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n. Në 65-vjetorin e tij të lindjes është dita të kujtojmë se Adem Jashari dhe udhëheqësit e luftës çlirimtare kanë qenë në anën e duhur dhe të drejtë të historisë, drejtësi të cilën e ka vërtetuar koha. Sot është dita të kujtojmë se populli, Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe udhëheqësit e saj ishin viktimat përballë agresorit dhe jo e kundërta. Sot është dita të besojmë se asgjë nuk mund ta errësojë luftën për liri, barazi, drejtësi e dinjitet të Adem Jasharit, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe popullit kosovar.”, shkruan në mesazhin e tij Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.



## Mesazhe urimi të Kryetarit të Kuvendit

### ■ Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, mesazh me rastin e 76-vjetorit të çlirimit: 29 nëntori, datë supreme në kalendarin e lirisë

**29 Nëntor 2020** - Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, ka sot një mesazh përshendetës me rastin e 29 nëntorit, 76-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë. “Në kalendarin e lirisë, 29 nëntori qëndron ndër datat më kryelarta të shqiptarëve. Është dita që kurorëzoi zgjedhjen e drejtë të partizanëve dhe patriotëve shqiptarë, në krahun e aleatëve të mëdhenj antifashistë. Është dita që realizoi ëndrrën e çlirimit të atdheut nga pushtuesit, e cila është vepër e çlirimtarëve dhe partizanëve shqiptarë. Çlirimi ishte rezultat i betejave të përgjakshme në malet, luginat, fshatrat dhe qytetet e Shqipërisë. Fitimtarë të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare nuk ishin thjesht dhe vetëm partizanët shqiptarë; ishte populli shqiptar; ishte vetë Shqipëria. Vlerat antifashiste qëndrojnë në themel të qytetërimit të sotëm europian e perëndimor dhe ato e shtyjnë botën drejt të ardhmes, progresit, paqes dhe zhvillimit. Kolaboracionizmi, si një kërcënim i lirisë, në format e tij të ndryshme, të vjetra e të reja, tradicionale e moderne, e tërheq botën drejt të kaluarës, pasigurisë, errësirës dhe regresit. Liria nuk është thjesht dhe vetëm fitorja mbi pushtuesit, me maliherët dhe fishekët rrëmbyer armikut. Liria e vërtetë qëndron në dashurinë tonë për të, të trashëguar brez pas brezi. Shpirtrat e lirë tënjerëzve të lirë janë mburoja e lirisë dhe garancia e saj. Kombet që dhunojnë lirinë e të tjerëve, nuk e meritojnë lirinë e tyre. Në çdo kohë e në çdo vend, popujt që luftojnë për tu çliruar nuk mund të quhen pushtues, dhe viktimat që luftojnë për liri, drejtësi e dinjitet, nuk mund të quhen agresorë. Lufta Antifashiste u bë në emër të të sotmes. Betejat e sotme për lirinë i bëjmë në emër të së ardhmes. Për lirinë luftohet në çdo kohë dhe nga gjithkush që e aspiron atë. Ashtu siç nderojmë partizanët çlirimtarë për luftën e tyre, nderojmë qytetarët në betejat e përditshme për punën, jetën dhe familjen; nderojmë mjekët dhe infermierët në vijën e parë të luftës për mbrojtjen e jetëve njerëzore. Lufta për lirinë fisnikëron kombin, atdheun, shoqërinë dhe çdo qytetar. Dje burimi i lirisë ishte lufta për çlirim, sot motivi i saj është lufta për vlerat thelbësore të shoqërisë, mirëqenien, solidaritetin, tolerancën dhe paqen.”, shkruan Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.